



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
REKTORATI  
REKTORI

Nr. 420 Prot.

Tiranë, më 29.04.2023

URDHËR  
NR. 29, DATË 24/04/2023

MBI

**“PAGESËN E TARIFËS SË STUDIMIT PËR STUDENTËT E CIKLIT TË TRETË  
“DOKTORATË NË ARTE SKENIKE” NË UNIVERSITETIN E ARTEVE”**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 39 dhe 77 e në vijim të tij, në pikën t, të nenit 27 të Statutit të Universitetit të Arteve, në Rregulloren e Programit të Studimeve të Ciklit III Për fitimin e gradës shkencore “Doktor” në Arte Skenike në Programet e Studimit të FAS pranë Njesisë Bazë të Regji dhe Regji Filmi & Televizioni në Fakultetin e Artit Skenik,

**U R D H Ë R O J:**

1. Pagesa e tarifës së studimit për ciklin e tretë të studimeve “Doktoratë në Arte Skenike” do të paguhet sipas afateve dhe masave të parashikuara në nenin 22 të Rregullores së Programit të Studimeve të Ciklit III Për fitimin e gradës shkencore “Doktor” në Arte Skenike në Programet e Studimit të FAS pranë Njesisë Bazë të Regji dhe Regji Filmi & Televizioni në Fakultetin e Artit Skenik.
2. Pagesa do të bëhet pranë Credins Bank me faturën për arkëtim të publikuar në faqen e web-it të UART/ [www.uart.edu.al](http://www.uart.edu.al).
3. Mandatpagesa do të dorëzohet nga studenti pranë zyrës së financës dhe një kopje i përcillet Fakultetit.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij Urdhri Administratori i UART, Fakulteti i Artit Skenik dhe DBNJI-P/A.
5. Ky urdhër të shpallet në faqen zyrtare Web të Universitetit të Arteve dhe tek transparenca.

**Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.**

**Prof. Kastriot ÇAUSHI**

**REKTOR**

**UNIVERSITETI I ARTEVE**